

ANGAZHIMI I PROFESIONISTËVE SHQIPTARË NGA DIASPORA NË VENDET E ORIGINËS

RAPORT I PUNËS KËRKIMORE

Autorët / Hulumtuesit:
Kaltrina Temaj dhe Lirim Krasniqi

Rishikuar nga:
Liza Gashi and Sihana Bejtullahu

Dizajn:
Think B

Publikuar nga: OJQ Germin
Tringë Smajli 48
10000 Prishtinë, Republic of Kosovo
+383 (0) 49 542 525
info@germin.org
www.germin.org

© 2020.  **germin**, të gjitha të drejtat e rezervuara

Mbështetur nga **giz** Deutsche Gesellschaft
für Internationale
Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

Përveç citimeve të shkurtra të bëra për qëllim kritike dhe riprodhimi, asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, transmetohet në çfarëdo forme ose me çfarëdo lloj mënyre, elektronike, përfshirë fotokopjimin, incizimin apo ruajtjen e informacionit e rikthimin e tij me anë të ndonjë sistemi, pa lejen paraprake të autorit.

Shënim:
Opinionet e shprehura në këtë botim janë të Germin, dhe nuk pasqyrojnë pikëpamjet zyrtare të *Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ)*.

Përmbledhje Ekzekutive	03
Hyrje	04
Histrotiku	05
Diaspora Shqiptare	07
Përmbledhje e Përgjithshme	07
Diaspora e Kosovës	08
Diaspora e Shqipërisë	10
Metodologjia e anketës	11
Hartimi i pyetësorit	11
Dizajnimi i Mostrës	11
Tabela 1. Kampionimi i përgjigjeve nga anketa	11
Mbledhja e të dhënave	12
Kontrolli i Cilësisë dhe Përpunimi i të dhënave	13
Analiza e të Dhënave	13
Intervistat	13
Rezultatet e anketës	14
<i>Karakteristikat e përgjithshme të profesionistëve të Diasporës që morën pjesë në studim</i>	14
Figura 1. Të dhëna demografike të të anketuarve	14
Figura 2. Vendet e origjinës së të anketuarve	14
Figura 3. Vendet banimit të të anketuarve	15
Figura 4. Sa vjet keni jetuar jashtë vendit tuaj të origjinës?	15
Figura 5. Sa herë brenda një viti vizitoni vendin tuaj të origjinës?	16
Figura 6. Cila ishte arsyeja kryesore për të lënë vendin e origjinës?	16
Figura 7. Cila është gjendja juaj civile në vendin e banimit?	17
Arsimi dhe sfondi profesional	18
Figura 8. Cili është niveli juaj më i lartë i edukimit?	18
Figura 9. A jeni duke punuar aktualisht?	18
Figura 10. Pozita aktuale e punës	19
Figura 11. Sfondi profesional	19
Figura 12. Përshkruani orarin tuaj të punës?	20
Figura 13. A përputhen kualifikimet tuaja me punën tuaj të tanishme?	20
Figura 13. 1. Nëse jo, pse?	21
Përceptimet mbi Angazhimin Profesional në Vendet e Origjinës	22
Figura 14. Sa të suksesshëm mendoni që të ishit nëse nuk do të kishit emigruar nga vendi juaj?	22
Figura 15. Sa të suksesshëm mendoni se do të ishit nëse do të ktheheshit në vendin tuaj të origjinës (duke marrë parasysh përgjigjet e tyre në pyetjen e mëparshme “Sa të suksesshëm mendoni që të ishit nëse nuk do të kishit emigruar nga vendi juaj?”	22

Figura 16. A keni qenë të angazhuar në vendet e origjinës si profesionist i diasporës?	23
Figure 16.1 Figura 16.1 Nëse jo, pse?	24
Figura 17. A keni marrë ndonjëherë ndonjë ftesë për t'u angazhuar profesionalisht në vendet e origjinës?	24
Figura 18. Çfarë do t'ju nxiste që të angazhoheni si ekspert në vendin e origjinës?	25
Angazhimi i Ardhshëm i Mundshëm në Vendet e Origjinës	26
Figura 19. A besoni se aftësitë tuaja do të ishin të dobishme për zhvillimin e vendit të origjinës?	26
Figura 20. Si do të ishit në gjendje të kontribuonit nëse u jepet shansi dhe mundësia?	27
Figura 21. Për cilën periudhë kohore do të ishit në gjendje të kontribuonit në vendin tuaj?	27
Figura 22. Cila periudhë gjatë vitit ju përshtatet më së miri për të kontribuar në vendin tuaj të origjinës?	28
Figura 23. Në cilin vend do të preferonit të transferonit njohuritë dhe aftësitë (kontributin) tuaja?	28
Figura 24. Në cilën fushë profesionale mund të kontribuoni në zhvillimin e vendit tuaj?	29
Figura 25. Në cilin institucion / organizatë do të preferonit të angazhoheni?	30
Figura 26. Në çfarë forme mendoni se do të ishte kontributi juaj në vendlindje?	31
Projekti për Angazhimin e Profesionistëve të Diasporës dhe Angazhimi në të Ardhmen	32
Figura 27. Si do ta përshkruanit nismën "Angazhimi i Profesionistëve të Diasporës"?	32
Figura 28. Sa jeni gatshëm që të ofroni kontributin tuaj në vendin e origjinës përmes programit "Angazhimi i Profesionistëve të Diasporës"?	32
Figura 29. Çfarë do ju nevojtej për ta lehtësuar angazhimin tuaj përmes këtij programi?	33
Konkluzione	34
Rekomandime	36
Referencat	38

Përmbledhje Ekzekutive

Ky studim është pjesë e projektit "Lidhja e ekspertëve të diasporës me nevojat institucionale në vendin amë", i cili implementohet nga Germin me mbështetjen e Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ). Projekti synon të rrisë angazhimin e profesionistëve të diasporës në vendet amë dhe të krijojë mundësi për shkëmbim dhe transferim të aftësive. Grupet e interesit përfshijnë profesionistë nga fusha të ndryshme që janë pjesë e diasporës Shqiptare që banojnë jashtë vendit, veçanërisht ata nga Gjermania.

Studimi synon të vlerësojë perceptimet mbi migrimin qarkor dhe angazhimin profesional të profesionistëve Shqiptarë të Diasporës në vendet e origjinës. Gjatë gjithë hulumtimit, konteksti i temës së emigracionit është të sjellë një sfond historik të evolucionit të diasporës shqiptare, në veçanti, të atyre me origjinë nga Kosova dhe Shqipëria. Ky studim analizon se si valët e ndryshme të emigracionit kanë ndikuar në krijimin e bashkësive të diasporës dhe lidhjet e tyre të forta me vendet e origjinës. Kjo e fundit dëshmohet jo vetëm nga kontributi historiko-ekonomik, politik dhe shoqëror, por edhe nga gatishmëria për të zhvilluar migrimin qarkor. Rezultatet nga ky raport tregojnë se shumica e të anketuarve janë të gatshëm dhe të përkushtuar të ofrojnë kontributin e tyre për vendin e origjinës.

Raporti gjithashtu ofron një përmbledhje të hollësishme të gjetjeve kryesore nga anketa me 921 të anketuar nga diaspora Shqiptare për të njëjtën temë, të kryer në pjesën e dytë të Janarit 2020.

Përfundimet e anketsë janë paraqitur në dy pjesë kryesore:

(1) Karakteristikat e përgjithshme dhe demografia e të anketuarve, si dhe prejardhja e tyre arsimore dhe profesionale; dhe

(2) Perceptimet mbi Angazhimin Profesional të Diasporës; Angazhimi i mundshëm në të ardhmen në vendet e origjinës; dhe Perceptimet mbi nismën e Germinit për zhvillimin e migrimit qarkor. Bazuar në rezultatet e anketës dhe studimit, janë dhënë 5 rekomandime për politikëbërësit, vendimarrësit dhe palët e tjera të përfshira, për të rritur angazhimin e diasporës për sa i përket migrimit qarkor:

(1) Njohja me profesionistët shqiptarë të diasporës; njihuni me shpërndarjen e tyre, dëgjojini dhe kuptojini;

(2) Të fuqizohen grupet dhe organizatat e diasporës;

(3) Të zhvillhet një platforme shumë-funkcionale që lidh profilet e profesionistëve të diasporës me sektorin publik dhe privat në vendet e origjinës;

(4) Të krijohet hapësirë për angazhimin e profesionistëve të diasporës në institucionet publike të Kosovës dhe Shqipërisë, të cilat kanë mungesë të njohurive dhe aftësive të avancuara në sektorët kryesorë;

(5) Të përmirësohet koordinimi midis niveleve të ndryshme të qeverisjes dhe institucioneve ndër-shtetërore dhe të rritet gjithëpërfshirja në procesin e angazhimit të diasporës.

Hyrje

“

Shprehja "profesionistë të diasporës" i referohet njerëzve të kualifikuar dhe të aftë me prejardhje migracioni që dëshirojnë të mbështesin vendin e origjinës duke e vënë në përdorim ekspertizën e tyre, siç përcaktohet nga Qendra për Migrim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (CIM).¹

Nisma e Germin "Angazhimi i Profesionistëve të Diasporës" synon të krijojë mundësi për transferimin e njohurive dhe aftësive në institucionet dhe organizatat vendore përmes angazhimit afatshkurtër që u ofrohet profesionistëve të diasporës me qëllim që të ndikojnë pozitivisht në zhvillimin socio-ekonomik të vendeve të origjinës. Në kuadër të kësaj nisme, Germin ka realizuar një studim hulumtues i cili synon të mbledhë dhe interpretojë perceptimet e profesionistëve të diasporës për angazhimin e mundshëm në vendin e tyre të origjinës dhe të identifikojë fushat / sektorët për angazhimin e këtyre profesionistëve. Për më tepër, për të hartuar një projekt të suksesshëm dhe për të arritur qëllime të përbashkëta, studimi synon të mbledhë mendimet e profesioneve të diasporës ndaj kësaj nisme pilot, si dhe rekomandimet e tyre për një zbatim të suksesshëm.

Ky studim përdor një metodologji të përzier të metodave sasiore dhe cilësore për të vlerësuar potencialin për kontributin profesional të diasporës në vendet e tyre të lindjes. Pjesa sasiore përbëhet nga një pyetësor i administruar online me 921 të anketuar të diasporës shqiptare për të mbledhur informacion në lidhje me përvojat dhe perceptimet e tyre drejt angazhimit të mundshëm profesional në vendet e tyre të origjinës. Studimi përfshin edhe gjashtë intervista të thella të bëra me profesionistë të diasporës për të ofruar më shumë informacion mbi gatishmërinë e diasporës për të kontribuar dhe për t'u angazhuar me vendet e origjinës përmes migrimit qarkor. Intervistat ofrojnë më shumë njohuri mbi sfidat e integritetit dhe kualifikimeve të profesionistëve nga diaspora dhe pengesat dhe mundësitë drejt angazhimit në vendet e origjinës. Raporti jep një përmbledhje të të dhënave nga studimi dhe në të gjitha nën-pjesët e tij jepet një përmbledhje më e detajuar e hapave të ndërmarra në këtë projekt kërkimor.

¹ "Diaspora Experts". Cimonline.De, 2020. <https://www.cimonline.de/en/html/diaspora-experts.html>

Historiku

Vendet e Ballkanit Perëndimor kanë diasporë të zgjeruar me një potencial të madh, megjithatë, ky potencial nuk ka qenë në gjendje të eksplorohej plotësisht përtej remitancave. Në këtë drejtim nuk është bërë shumë, as nga shoqëria civile, por as sektori privat. Mungesa e përvojës, narracionet negative për emigracionin dhe një qasje komunikimi e njëanshme janë disa nga arsyt kryesore që pengojnë angazhimin profesional të komuniteteve të diasporës me vendet e origjinës. Sidoqoftë, potenciali i diasporës po rritet dhe po kështu edhe interesi i akademisë, studiuesve, organizatave dhe institucioneve për të eksploruar këtë potencial. Kjo e fundit është e rëndësishme pasi inkurajon diskutimet që rezultojnë në rekomandime, strategji dhe zgjidhje praktike për angazhimin e diasporës në funksion të zhvillimit të vendeve të origjinës.

Njohuritë dhe transferimi i aftësive të diasporës janë thelbësore në zbutjen e efekteve negative të fenomenit 'brain drain' dhe mund të ndihmojnë vendin të shkojë drejt një shoqërie të bazuar në dije. Sidoqoftë, pritshmëritë që anëtarët e diasporës të kthehen në vendin e origjinës, të cilët tashmë e kanë ndërtuar një jetë jashtë vendit, janë të ulëta. Si rrjedhim,



tërheqja e ekspertëve të diasporës për t'u angazhuar profesionalisht, kërkon një qasje serioze dhe të planifikuar mirë që ruan interesat individuale të anëtarëve ndërsa arrin një qëllim më të madh të përbashkët.

Potenciali i diasporës për të promovuar zhvillimin në atdheun e tyre ka fituar interes të rëndësishëm vitet e fundit. Studimet tregojnë që dërgesat nga emigrantët janë një kontribues i rëndësishëm në zhvillimin e vendit amë.² Sidoqoftë, kontributi i diasporës përveç remitancave shtrihet edhe në sipërmarrje, biznes dhe investime në vendet e tyre të lindjes, së bashku me kapitalin, teknologjinë, njohuritë teknike dhe njohuritë e tregut³, si dhe kontributi social (ide, kapital shoqëror) që vijnë nga vendet rezidente tek vendet amë.⁴

Për rrjedhojë, duhet të ketë një përqëndrim më të madh në potencialin e rritjes dhe zhvillimit, veçanërisht mes vendeve në zhvillim si rezultat i ekspertizës profesionale dhe përvojës së diasporës së tyre që jeton në vendet e zhvilluara. Ky kontribut përveç dërgesave mund të vijë në formën e angazhimit të profesionistëve të diasporës duke siguruar njohuri dhe transferim të aftësive të tyre në vendet amë, duke ndikuar gjithashtu edhe në forcimin e lidhjeve me vendin e origjinës dhe për të arritur një ndjenjë të vetë-përmbushjes. Për këtë arsye është thelbësore që të keni një pasqyrë më të thelluar dhe të bëjmë një vlerësim të nevojave për të identifikuar mënyrat më të mira për ngritjen e një bashkëpunimi të tillë në të ardhmen mes profesionistëve të diasporës dhe vendeve të origjinës - vendet amë.

²Markova, Eugenia (2010), "Effects of Migration on Sending Countries: lessons from Bulgaria," GreeSE - Hellenic Observatory Papers on Greece and Southeast Europe 35, Hellenic Observatory, LSE. <http://eprints.lse.ac.uk/28438/>.

³Sharma et al (2011), Realizing the development potential of diaspora, United Nations University Press ISBN 978-9280811957 <https://collections.unu.edu/eserv/UNU:2532/ebrary9789280811957.pdf>

⁴Levitt, P. (1998). Social Remittances: Migration Driven Local-Level Forms of Cultural Diffusion. The International Migration Review, 32(4), 926-948.

Gjatë dekadave të fundit, emigracioni apo diaspora është trefishuar në botë, me rreth 250 milion njerëz që jetojnë jashtë vendeve të tyre të origjinës

Për vendet e origjinës, kontributi kryesor nga komunitetet e diasporës ka ardhur në formën e dërgesave financiare, që ka rritur konsumin kombëtar dhe ka rritur Prodhimin e Brendshëm Bruto (PBB); megjithatë, angazhimi i diasporës ka qenë me potencial të ulët sa i përket fushave të tjera. Edhe pse ka vend për analiza në lidhje me këtë çështje, një gjë që po bëhet më e qartë është se komunitetet e diasporës dhe angazhimi i tyre me vendet e lindjes janë një pjesë integrale e zhvillimit.

Komunitetet e diasporës që jetojnë jashtë vendlindjeve të tyre apo vendeve të origjinës mund të rrisin kontributin e tyre në forma të ndryshme dhe përmes llojeve të ndryshme të angazhimit. Së pari, komunitetet e diasporës mund të shërbejnë si një mjet për transferimin e burimeve/resurseve të tilla si dija, aftësitë teknike, dhe ide të reja që mund të kontribuojnë në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror.⁵ Së dyti, potenciali investues i komuniteteve të diasporës, përveç përfitimeve financiare, është i nxitur gjithashtu nga lidhja emocionale në vendet e tyre të lindjes/origjinës. Një lidhje e tillë për të kontribuar në atdheun e tyre shtyn dëshirën e tyre për mundësi investimi drejt

zhvillimit të qëndrueshëm duke marrë parasysh njohuritë e kontekstit lokal dhe qasja në rrjetet lokale në vendin e origjinës.⁶ Së fundmi, investimet në diasporë në formën e kontributeve profesionale mund të kenë një ndikim afatgjatë dhe të shërbejnë si një burim alternativ financimi⁷ për zhvillim. Si përfundim, është e qartë që ka një ndikim pozitiv nga angazhimi i diasporës dhe kontributit të tyre në vendet e origjinës, të cilat mund të arrihen përmes planifikimit strategjik për bashkëpunimit profesional.

⁵ De Haas, Hein, (2010), "Migration and Development: A Theoretical Perspective." International Migration Review 44, no. 1: 227-64.

⁶ Debass, T., & Ardivino, M. (2009). Diaspora direct investment (DDI): The untapped resource for development. United States Agency for International Development. USAID publication, website: http://pdf.usaid.gov/pdf_docs/PNADO983.pdf.

⁷ Uruguchi et al, (2018), Diaspora Communities as a Driving force for Development: Is there a "Business case" HELVETAS.

Diaspora Shqiptare

Përmbledhje e Përgjithshme

Diaspora Shqiptare ka luajtur një rol të rëndësishëm në zhvillimin dhe rritjen e vendeve të origjinës. Duke pasur parasysh rrethanat historike, anëtarët e diasporës janë organizuar vullnetarisht, duke krijuar dhe ruajtur lidhje me atdheun, pavarësisht kushteve të pafavorshme.

Rrethi i gjërë i diasporës nga Kosova, pavarësisht se nuk e kemi një numër zyrtar, vlerësohet të jetë rreth 800,000 njerëz.⁸ Mendohet se një në tre kosovarë jeton jashtë vendit. Ndërsa, në Shqipëri sipas INSTAT, numri i emigrantëve është rreth 1.6 milion njerëz.⁹ Vendet kryesore ku është vendosur Diaspora Shqiptare janë: Gjermania, Zvicra, Italia, Greqia dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ndërsa vendet e tjera përfshijnë Suedinë, Mbretërinë e Bashkuar, Francën, Austrinë dhe Belgjikën me numër më të vogël.

Angazhimi i Diasporës ka qenë me shumë rëndësi për Kosovën dhe Shqipërinë, por edhe vendet e tjera të rajonit. Diaspora e sotme e Kosovës është një kontribues i madh ekonomik dhe shoqëror.



Dërgesat financiare në Kosovë përbëjnë nga 10 - 15 % të PBB-së së vendit në vitet e fundit. Një ndikim i ngjashëm por me një përqindje më të ulët (rreth 10%) të dërgesave në PBB regjistrohet në Shqipëri sipas Bankës së Shqipërisë.¹⁰

Sipas Programit për Zhvillim të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, 25 % e familjeve të Kosovës marrin remitanca vazhdimisht.¹¹ Duke pasur parasysh papunësinë e lartë, dërgesat e emigrantëve kanë ruajtur stabilitetin socio-ekonomik. Të dhënat nga Banka Qendrore e Kosovës tregojnë se remitancat arritën rreth 852 milion euro për vitin 2019¹², vlerë kjo më lartë se viti paraprak. Duhet pasur parasysh që këto shuma numërojnë vetëm transaksionet e regjistruara përmes kanaleve zyrtare financiare, pasi vlerësohet se diaspora e Kosovës sjell rreth 2 miliardë euro në vit përfshirë shpenzimet gjatë pushimeve si dhe investimet direkte në Kosovë. Si rrjedhojë, roli i Diasporës në promovimin e mundësive për investime, flukset hyrëse të kapitalit dhe zhvillimit është shqyrtuar më tej në këtë raport.

Duke marrë parasysh potencialin e madh ekonomik, intelektual dhe kulturor të diasporës, ka pasur pritshmëri dhe planifikim në rritje midis politikëbërësve dhe specialistëve të zhvillimit për të eksploruar më tej këtë rol dhe për të rritur kontributin e tyre në vendet e origjinës. Literatura tregon se emigrimi në një vend tjetër mund të ketë një ndikim pozitiv në vendlindje në drejtim të uljes së varfërisë, promovimit të punësimit, aktiviteteve të reja ekonomike, rritjes së tregtisë dhe investimeve, si dhe rritjes së konsumit dhe zhvillimit të turizmit.¹³ Studimet tregojnë se rreth 56 % e popullsisë së diasporës

⁸ Po aty.

⁹ "Diaspora e Shqipërisë në Shifra". Instat.Gov.AL, 2019. <http://www.instat.gov.al/media/6547/diaspora-2019.pdf>.

¹⁰ "Remitancat: Një Mbështetje Për Zhvillim". Bank of Albania, 2018. https://www.bankofalbania.org/rc/doc/Remitancat_Re-vista_11930.pdf.

¹¹ "Kosovo Remittance Study". United Nations Development Programme, 2012. https://www.undp.org/content/dam/kosovo/docs/Remittances/KRS2012_English_858929.pdf.

¹² "Kosovo | Remittances | Economic Indicators". Ceicdata.Com. Qasur me 21 Janar 2020. <https://www.ceicdata.com/en/kosovo/balance-of-payments-remittances-by-channel/remittances>.

¹³ Dahiden, Warner (2009) Diaspora as a Driving Tool for Development in Kosovo, Myth or Reality Swiss Agency for Development and Cooperation and Forum for Democratic Initiatives https://www.eda.admin.ch/dam/deza/en/documents/laender/re-source-183043_EN.pdf

është midis 20 dhe 50 vjeç, që do të thotë se ajo përbëhet nga një komunitet i aftë për punë i cili mund të sigurojë dërgesa në vendin amë.¹⁴ Si rezultat, edhe komuniteti i diasporës shqiptare mund të krijojë shumë ndikime pozitive në vendet amë.

Procesi i valëve të ndryshme të emigrimit nga Kosova dhe Shqipëria ndër vite ka pasur një efekt domethënës në strukturën e popullatës në vend me rreth një të tretën e popullsisë së Kosovës që jeton aktualisht jashtë, dhe pothuajse 40% të popullsisë së Shqipërisë.

Diaspora e Kosovës

Ka pasur katër faza të identifikuar të emigracionit të Kosovës. Faza e parë e emigracionit konsiderohet periudha para vitit 1989, e cila u karakterizua nga lëvizja e të rinjve të pa kualifikuar nga zonat rurale të Kosovës drejt Gjermanisë apo Zvicrës në ndjekjen e mundësive të punësimit. Kjo valë përfshin ata persona të cilët shkuan në vendet e tjera si punëtorë në vitet 1960 për të mbështetur financiarisht familjet e tyre duke dërguar para dhe investuar në shtëpitë e tyre.¹⁵

Fluksi i emigrimit u ngadalësua disi në vitet 1970 kur Kosova fitoi autonomi brenda ish-Jugosllavisë dhe sektori publik apo ndërmarrjet private krijuan vendet e reja pune. Në këtë pikë, situata ekonomike dhe politike në vend ishte më e qëndrueshme dhe për këtë arsye më pak shqiptarë të Kosovës po linin vendin për të kërkuar mundësi më të mira.

Vala e dytë e emigrimit nga Kosova ishte gjatë viteve 1989-1997 kur situata në vend u përkeqësua dhe më shumë se 150,000 punëtorë kosovarë u pushuan nga vendet e tyre të punës në sektorin publik.¹⁶

Duke marrë parasysh situatën ekonomike dhe politike gjatë këtyre viteve, shumë të rinj të aftë dhe të arsimuar emigruan në vendet perëndimore për të kërkuar mundësi pune dhe për të shpëtuar nga shërbimi ushtarak i Jugosllavisë¹⁷. Duke marrë parasysh që kishin lënë pas familjet e tyre, emigracioni në këto vende ishte një mënyrë për të gjetur punë për të mbajtur financiarisht familjen dhe për të përmirësuar mirëqenien e tyre përmes dërgesave financiare. Për shumë pjesëtarë të Diasporës së Kosovës, qëllimi i emigrimit ka mbetur i njëjtë, ku shumica e tyre punojnë për të mbështetur familjet dhe duke investuar në vendet e tyre me shpresën se një ditë ata do të mund të kthehen për të vazhduar jetën pranë familjeve dhe të afërmeve të tyre.

Vala e tretë e migracionit nga Kosova u zhvillua gjatë viteve të konfliktit të 1998/1999, këtu më shumë se 800,000 qytetarë kosovarë kërkuar strehim në Shqipëri, Evropën Perëndimore dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Natyra e kësaj valë emigrimi u bazua në nevojat emergjente në kërkim të

¹⁴ Po aty.

¹⁵ Arenliu et al (2014) Kosovo Human Development Report (2014) United Nations Development Programme, Swiss Cooperation Office Kosovo https://www.ecoi.net/en/file/local/1079594/1226_1418899302_undp-kosovo.pdf

¹⁶ Nushi, A., & Alishani, A. (2012). Migration and development: the effects of remittances on education and health of family members left behind for the case of Kosovo. Analytical, 5(1), 42-57.

¹⁷ Arenliu et al (2014) Kosovo Human Development Report (2014) United Nations Development Programme, Swiss Cooperation Office Kosovo https://www.ecoi.net/en/file/local/1079594/1226_1418899302_undp-kosovo.pdf

sigurisë gjatë peridhës së konfliktit, dhe pas vitit 1999 shumë emigrantë u kthyen duke rezultuar në një kthim të shpejtë të popullatës së zhvendosur.

Vala e fundit e emigrimit është regjistruar pas vitit 1999, ku shumë shqiptarë të Kosovës po shkonin në vendet perëndimore për t'u ribashkuar me familjet e tyre apo për të gjetur mundësi më të mira për zhvillim dhe jetesë. Emigrantët e rinj ishin kryesisht të pakualifikuar dhe të pa arsimuar, të cilët po emigronin në vendet më të zhvilluara duke përdorur edhe emigrimin të parregullt, ndërsa individë të tjerë të arsimuar po kërkonin emigrim të përkohshëm ligjor përmes programeve të studimit ose kontratave të punës.¹⁸ Si rezultat, këto katër valë të identifikuar të emigrimit në histori kanë kontribuar në rritjen e Diasporës së Kosovës në vendet perëndimore, të cilat kanë patur një ndikim të madh në vend.



Edhe pse liberalizimi i vizave mbetet çështje për qytetarët e Kosovës për arsye se atyre u kërkohet vizë Shengen për të udhëtuar në ndonjë prej vendeve të Bashkimit Evropian, kjo nuk e ka ngadalësuar emigrimin.

Të dhënat nga Eurostat mbi uljen e numrit të popullsisë për vendet e Evropës Lindore ndërmjet viteve 2007 dhe 2018, tregojnë se Kosova ka përjetuar një rënie prej 15.4 % të popullsisë.¹⁹ Kjo konsiderohet të jetë rënia më e madhe krahasuar me vendet e tjera të Evropës Lindore. Numri më i lartë u

regjistrua në fillim të vitit 2015 dhe ishte rreth 42,000 kosovarë të cilët kishin aplikuar për azil në BE ndërsa në vitin 2016 më shumë se 21,000 kosovarë kanë aplikuar për azil siç pasqyrohet nga Eurostat Data.²⁰ Vlerësimet tregojnë gjithashtu se rreth 144.330 qytetarë kosovarë kanë hyrë ilegalisht në BE. Një studim tjetër i publikuar në vitin 2019 nga Instituti i Politikave Evropiane të Kosovës tregon se rreth 203.330 qytetarë të Kosovës u larguan nga vendi dhe kanë kërkuar azil në vende të ndryshme në Bashkimin Evropian.²¹

Statistikat nga Eurostat tregojnë se pjesa më e madhe e qytetarëve të Kosovës që kanë fituar shtetësinë, e kanë arritur në Gjermani (47%), Itali (12%), Francë dhe Austri (9% secila) dhe Slloveni (7%). Një në pesë kosovarë ka interes të largohet nga Kosova me çdo mënyrë, dhe arsyeja kryesore mbetet punësimi. Duke marrë parasysh që shkalla e papunësisë në Kosovë është 31.4 % dhe më shumë se gjysma e të rinjve janë të papunë, shumë qytetarë kërkojnë mundësi të reja në vendet e tjera.

¹⁸ Po aty.

¹⁹ Walker Sh. (2019), Eastern Europe's extraordinary revival, The Guardian <https://bit.ly/39faBQK>

²⁰ Rolandi F., Elia Ch, (2019) Escape from the Balkans, European Data Journalism, Osservatorio Balcani Caucaso Transeuropa <https://bit.ly/2OKp1PD>

²¹ Po aty.

Diaspora e Shqipërisë

Emigrimi i qytetarëve të Shqipërisë jashtë vendit ka qënë i pandërprerë përgjatë viteve. Nga shekujt XV dhe XVI është dokumentuar largimi i një numri të madh njerëzish nga territoret e populluara me shqiptarë. Pushimi i Gadishullit Ballkanik nga Perandoria Osmane dhe vdekja e Gjergj Kastriotit - Skënderbeut, rezultoi në një valë emigrimi në Italinë e Jugut, Greqi, brigjet e Dalmacisë (Kroacia e sotme jugperëndimore) dhe gjetkë. Komuniteti më i spikatur i shqiptarë i krijuar nga kjo valë emigrimi është ai i komunitetit arbëresh që ndodhet në Sicili dhe Kalabri të Italisë. Në shekujt vijues, deri në krijimin e shtetit të pavarur shqiptar, në vitin 1912, fazat e emigrimit vazhduan në formën e lëvizjeve "të brendshme" nga trevat shqiptare në rajone të tjera të Perandorisë Osmane, si Turqia e sotme, Egjipti, Siria, Bullgaria dhe Rumania.

Formimi i shtetit shqiptar ndryshoi rrugët e emigrimit për shqiptarët. Emigrimi në Turqi vazhdoi përsëri, kryesisht për shkak të lidhjeve dhe marrëdhënieve me ata që ishin vendosur atje më parë. Sidoqoftë, shqiptarët tani ishin të orientuar drejt Shteteve të Bashkuara, Amerikës Latine, Australisë dhe në një numër më të kufizuar drejt vendeve Europiane (Francë, Austri, Itali).

Një kontigjent i veçantë gjatë kësaj kohe ishte emigracioni politik, të cilët u larguan nga Shqipëria si rezultat i kundërshtimit ndaj regjimit të Mbretit Zog dhe pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore.

Në periudhën 1945-1990, u vu re pothuajse një zhdukje e emigrimit, për shkak të izolimit dhe mbylljes së kufijve nga regjimi komunist.

Që nga fundi i regjimit komunist (1990), rreth 25% e popullsisë së përgjithshme, që pasqyron rreth 35% të popullsisë aktive, është larguar nga vendi. Në fillim, tendenca e emigrantëve shqiptarë ishte e orientuar drejt Greqisë dhe Italisë, por me kalimin e viteve ajo është orientuar drejt vendeve më të zhvilluara të Evropës Perëndimore (Gjermani, Hollandë, vendet skandinave, Britania e Madhe, etj.), si dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Kanada).²²

Duke analizuar lëvizjen e njerëzve nga Kosova dhe Shqipëria në vitet e fundit, një valë e re emigrimi duket të ketë lindur për arsye të ndryshme bazuar në situatën ekonomike dhe aspiratat personale për një të ardhme më të mirë.

²² Albanians in the World, Ministry For Europe And Foreign Affairs, qasur me 21 Maj 2020, <https://bit.ly/2ZOcDEG>

Metodologjia e anketës

Hartimi i pyetësorit

Për të mbledhur mendimet dhe perceptimet e komuniteteve diasporë rreth migrimit qarkor dhe mundësive të angazhimit profesional në vendin e tyre, Germin hartoi një pyetësor të strukturuar sasior të zhvilluar me 921 të anketuar nga diaspora. Ky pyetësor mblodhi informacione të përgjithshme për profilin e profesionistëve të diasporës, punësimin dhe profesionin në vendin ku janë vendosur, fushën e ekspertizës, aftësitë dhe kualifikimet, si dhe gatishmërinë e tyre për t'u angazhua në të ardhmen në perspektiva të ndryshme profesionale në vendlindje.

Për më tepër, pyetësori synon të identifikojë se cilat janë mundësitë që do të tërheqnin profesionistët e diasporës për t'u angazhuar në transferimin e njohurive dhe aftësive në vendlindje dhe në këtë mënyrë të kontribuojnë në zhvillimin e vendit në fusha të ndryshme.

Pas përfundimit të pyetësorit në gjuhën shqipe, ai u përkthye edhe në anglisht. Pyetjet u kontrolluan për të siguruar që thelbi qëndron dhe kuptimi i tyre është i njëjtë në të dy gjuhët.

Dizajnimi i Mostrës

Grupi i interes në këtë studim janë profesionistë të diasporës që banojnë në vende të ndryshme, të cilët u shpërngulën nga vendet e tyre të origjinës (kryesisht nga Kosova dhe Shqipëria, përfshirë vendet e tjera nga rajoni ku jetojnë shqiptarët) dhe kanë angazhime profesionale në fusha të ndryshme. Për të kapur interesin e populates, Germin shënjestroi rrjetet e komuniteteve të diasporës përmes platformave në

internet për të shpërndarë këtë anketë në faqen e zyrtare (www.germin.org) si dhe faqet e mediave sociale (Facebook, LinkedIn, Twitter). Anketa u administrua në internet, duke mbledhur informacione nga 921 të anketuar për të vlerësuar mendimet dhe perceptimet e tyre për angazhimin e mundshëm profesional në vendet e tyre të lindjes/origjinës dhe mundësitë për kontribut profesional në afat të shkurtër dhe afatgjatë.

Tabela 1. Kampionimi i pergjigjeve nga anketa

VENDLINDJA / ORIGJINA	NUMRI I TË ANKETUARVE
REPUBLIKA E KOSOVËS	538
REPUBLIKA E SHQIPËRISË	299
VENDE TË TJERA NGA RAJONI - MAQEDONIA E VERIUT, MALI I ZI, SERBIA (LUGINA E PRESHEVËS)	84
TOTALI	921

Mbledhja e të dhënave

Pas përfundimit dhe përkthimit në shqip dhe anglisht, pyetësi u kodua në platformën SurveyMonkey dhe u testua për të siguruar që përfundimi të funksionojë pa probleme. Pas testimit të anketat, pyetësi u redaktua në të dy gjuhët për të përkthyer formulimet të pyetjeve dhe modifikimeve të tjera teknike në formatin e pyetësit.

Në administrimin e pyetësorëve në internet, është e rëndësishme të sigurohet që pyetjet të kenë një rrjedhë logjike, të jenë të lehta për t'u kuptuar dhe plotësuar. Për këtë projekt, numri i pyetjeve dhe koha për të përfunduar anketën u morën në konsideratë për të siguruar saktësinë e përgjigjeve dhe shpërndarjen e informacionit inteligjent. Anketat u administruan në internet nga 15 deri në 30 Janar 2020.

Është e rëndësishme të theksohet se gjetjet nga anketa nuk janë të përgjithësueshme për të gjithë komunitetet e diasporës që jetojnë jashtë vendit, por synojnë grupin e profesionistëve në fusha të ndryshme. Duke marrë parasysh që anketa është administruar në internet, ekzistojnë disa kufizime në përgjithësimin e rezultateve për të gjithë komunitetet e diasporës për shkak të popullsisë së mostrës dhe paragjykitit potencial të mos-përgjigjeve.

Paragjykimin i marrjes së mostrës (Sampling bias): Administrimi i anketës në internet kufizon në mënyrë të pashmangshme zgjedhjen e barabartë të mostrës përfaqësuese të popullatës së synuar për t'u intervistuar. Përdoruesit më aktivë në internet do të jenë vazhdimisht më të ekspozuar ndaj anketës në krahasim me ata që nuk janë në mënyrë aktive në internet ose nuk kanë qasje në internet ose teknologji. Në këtë rast, të dhëna si mosha apo të ardhurat e të anketuarve gjithashtu janë të rëndësishme të merren parasysh. Për të minimizuar paragjykimin e marrjes së mostrave, Germin ka maksimizuar shikueshmërinë e anketës përmes kanaleve të shumta, përfshirë mediat sociale, faqet e internetit dhe postës elektronike.

Paragjykimi i mos-përgjigjeve (Non response bias): Përveç paragjykitit të marrjes së mostrave, është e rëndësishme të kuptohet që të anketuarit që marrin pjesë në këtë studim mund të jenë sistematikisht të ndryshëm nga ato që nuk marrin pjesë në anketim. Në këtë rast, pjesëmarrësit mund të ishin interesuar për këtë temë dhe për këtë arsye i kushtuan kohën e tyre për të përfunduar studimin, në krahasim me grupet e tjera. Një shkallë më e madhe e reagimit, në këtë rast, do të ndihmojë në kompensimin e njëanshmërisë dhe rezultatet mund të shihen në dritën e karakteristikave të ndryshme demografike për të patur një përfundim më të saktë.

Kontrolli i Cilësisë dhe Përpunimi i të dhënave

Administrimi në internet i pyetësorit është një metodë e përshtatshme dhe me kohë efikase për të kapur interesin e popullatës, në këtë rast, profesionistët e diasporës, duke marrë parasysh që kjo na lejon të mbledhim informacione nga distanca nga të anketuarit që jetojnë në vende të ndryshme. Sidoqoftë, gjatë përfundimit të anketave në internet, pengesa zakonisht mund të jetë cilësia e përgjigjeve që mund të ndikojnë në vlefshmërinë e gjetjeve të studimit. Prandaj, kontrolli i cilësisë u krye gjatë gjithë administrimit të anketës për përgjigjet që kishin nevojë për përpunim të të dhënave dhe për

të siguruar që nuk ka probleme me pyetësorin.

Për të siguruar që anketa të mbledhte me saktësi informacionin nga grupet e interesit, përpunimi profesional i të dhënave u krye për shumë arsye duke përfshirë përgjigje të pasakta me fjalor, të cilat vijnë nga shpejtësia, përgjigje që nuk përputhen me pyetjet e bëra, gabime në zgjedhjen e përgjigjes së saktë, në përgjigje jo konstante për pyetje të ndryshme (pyetje logjike), të dhëna që mungojnë dhe gabime të tjera në bazën e të dhënave. Ky proces siguron saktësinë e gjetjeve dhe përgatit të dhënat për analizë.

Analiza e të Dhënave

Pas përfundimit të përpunimit të të dhënave, ato u analizuan duke përdorur softuerin SPSS. Analiza siguron statistika përshkruese dhe inferenciale, duke paraqitur gjetjet në grafikët që përdorin Excel dhe Infogram.com për vizualizim në raportin përfundimtar. Për më tepër, analiza përdori

kryqëzimin e tabelave si dhe ndryshoreve të tjera demografike të të anketuarve për të kapur informacionin e nevojshëm në përputhje me objektivat e studimit. Një raport përfundimtar për gjetjet e anketës është mundësuar në kapitujt më poshtë.

Intervistat

Për të fituar më shumë njohuri nga profesionistët e diasporës dhe perceptimet e tyre për angazhim në të ardhmen në vendin amë, ky studim përfshiu disa intervista të thella me profesionistë të diasporës. Pas gjetjeve nga anketa, një udhëzues për intervistë u përgatit me pyetje të ndryshme për të marrë më shumë njohuri mbi perceptimet e diasporës për kontribute profesionale në mënyra të ndryshme.

Intervistat u realizuan përmes Skype me gjashtë (6) persona të ndryshëm. Para intervistës u nënshkrua një Formular i Mirëmbajtjes së Informacionit, si nga intervistuesi ashtu edhe nga të intervistuarit, duke i dhënë këtij të fundit informacion të mjaftueshëm të detajuar mbi studimin, në mënyrë që ata të mund të merrnin një vendim

të informuar, vullnetar dhe racional për të marrë pjesë në intervistë. Nga gjashtë të intervistuarit, katër janë me origjinë nga Kosova, një nga Shqipëria dhe një nga Mali i Zi. Të gjithë ata jetojnë në vendet evropiane, përveç një që jeton në SH.B.A. Të gjashtë (6) prej tyre kanë prejardhje të ndryshme profesionale.

Përzgjedhja e metodologjisë së të intervistuarve ishte bazuar në terma të ekspertizës për të pasur diversitet në këtë drejtim dhe për të shmangur përgjigjet e njëanshme kur bëhet fjalë për rëndësinë e potencialit të sektorëve ekonomikë në angazhimin në vendet amë. Përgjigjet e tyre shtohen si citime në pjesët e ndryshme të këtij raporti, në varësi të rëndësisë së çështjeve dhe temave të adresuara nga anketa.


Rezultatet e anketës

Karakteristikat e përgjithshme të profesionistëve të Diasporës që morën pjesë në studim

Kjo pjesë e raportit paraqet gjetjet nga studimi i kryer me profesionistë nga Shqipëria dhe Kosova që banojnë jashtë vendit. Anketa u administrua në internet përmes Survey Monkey i përbërë nga 30 pyetje në total për të marrë informacion më të thelluar në lidhje me sferën profesionale dhe potencialin për t'u

përfshirë në iniciativën "Angazhimi i Profesionistëve të Diasporës në Vendlin e Origjinës". Anketa u plotësua nga 921 të anketuar; 58% ishin burra dhe 42% gra. Për sa i përket grupmoshës, shumica e të anketuarve i përkisnin grupmoshës 26-35 vjeç (41%) dhe 36 deri 45 vjeç (32%).


Figura 1. Të dhëna demografike të të anketuarve



Vendi i origjinës për më shumë se gjysmën e të anketuarve ishte Kosova (58%), e ndjekur


nga Shqipëria (32%), Maqedonia e Veriut (6%) dhe vendet e tjera të rajonit.

Figura 2. Vendet e origjinës së të anketuarve



Rreth 30 përqind e të anketuarve aktualisht jetojnë në Gjermani, rreth 18 përqind jetojnë në Shtetet e Bashkuara dhe 10 përqind në Zvicër.

Figura 3. Vendet banimit të të anketuarve




Të anketuarit e tjerë aktualisht jetojnë në Austri (5%), Danimarkë (5%), Mbretërinë e Bashkuar (5%), Itali (4%) dhe vende të tjera të paraqitura në grafikun e mëposhtëm.

Shumica e profesionistëve të diasporës të anketuar kanë jetuar jashtë vendit të origjinës për më shumë se 15 vjet (52%). Rreth 23 përqind e tyre kanë jetuar jashtë vendit të origjinës për një periudhë 5 deri në 15 vjet,

ndërsa 11 përqind kanë jetuar jashtë vendit të origjinës për një periudhë nga një deri në pesë vjet. Vetëm katër përqind e të anketuarve kanë qenë pjesë e diasporës për më pak se një vit.

Figura 4. Sa vjet keni jetuar jashtë vendit tuaj të origjinës?



Një komponent i rëndësishëm për të kuptuar lidhjet e diasporës me vendin amë është numri i vizitave në vit. Gjetjet nga anketa tregojnë se pothuajse gjysma e të anketuarve vizitojnë vendin e origjinës së paku një herë brenda vitit (45%) e ndjekur nga një e katërta e tyre që vizitojnë vendin të paktën dy herë

brenda vitit (25%). Një pjesë e konsiderueshme e të anketuarve vizitojnë vendet e tyre të lindjes tre ose më shumë herë brenda vitit; ndërsa, vetëm pesë përqind e tyre raportuan se nuk do të ktheheshin më për vizitë në vendet e tyre të origjinës.


Figura 5. Sa herë brenda një viti vizitoni vendin tuaj të origjinës?



Arsyet më të zakonshme të emigrimit ishin studimi, arsyet ekonomike, bashkimi familjar dhe situata politike në Kosovë gjatë luftës. Rreth një e treta e të anketuarve u larguan për të studiuar në një vend tjetër, ndërsa 20 përqind emigruan për arsye ekonomike (siç është mundësitë e punësimit). Intervistat me profesionistë e diasporës zbulojnë se mundësitë e studimit jashtë vendit ishin një faktor tërheqës edhe për gjeneratat e reja gjatë valëve të emigrimit të viteve 90-ta, në një kohë kur një faktor shtytës ishte mbyllja me

me forcë e Universitetit të Priştinës nga regjimi serb.²³ Për 17 përqind të të anketuarve, arsyeja kryesore për emigrim ishte bashkimi familjar me anëtarët e tjerë që jetonin në Diasporë, ndërsa 12 përqind u larguan nga persekutimi politik në vendin e tyre. Arsyet e tjera për të lënë vendin e origjinës përfshinin të qenit refugjat i luftës gjatë kohës së konfliktit, të emigruarit me familjen, ose ndjekja e mundësive më të mira për avancimin në karrierë.

Figura 6. Cila ishte arsyeja kryesore për të lënë vendin e origjinës?




Për më tepër, intervistat me profesionistë të diasporës konfirmojnë se një numër i konsiderueshëm familjesh që u larguan nga Kosova gjatë kohës së konfliktit ose për shkak të përndjekjes politike janë vendosur jashtë vendit dhe kanë ndërtuar një jetë të re atje. Gjysma e të anketuarve nga anketa raportuan se kanë shtetësi në vendin e banimit (50%) ndërsa një e katërta e tyre kanë një leje

qëndrimi të përhershëm (25%) dhe 18 përqind kanë një leje qëndrimi të përkohshëm. Vetëm një përqind janë azilkërkues në vendin e vendbanimit ndërsa gjashtë përqind e të anketuarve në të vërtetë po ndjekin studimet e tyre në nivel Master ose Doktoratë jashtë vendit të tyre të origjinës.

²³ Dobruna, Kujtim (2020), intervistë e realizuar nga L.Krasniqi, me 24 Shkurt, 2020, përmes E-mail.

Figura 7. Cila është gjendja juaj civile në vendin e banimit?



Brezi i dytë i familjeve të emigrantëve nuk ka dëshirë të kthehet në Kosovë për shumë arsye, duke përfshirë mungesën e stabilitetit politik në vend, korrupsionin, qeverisjen e keqe dhe qasjen abuzive ndaj burimeve publike. Mimoza Murati, studente në Kopenhagë (Danimarkë) thotë se edhe pse prindërit e saj ishin ata që ikën nga Kosova për shkak të luftës dhe ata janë vendosur shumë mirë në Danimarkë, ajo do të ishte e gatshme të kthehej në Kosovë, por mungesa e stabilitetit

politik në vend, korrupsioni, qeverisja e keqe dhe qasja abuzive ndaj burimeve publike²⁹ janë ndër arsyet që e mbajnë atë të vazhdojë jetën jashtë vendit.²⁴ Shumica e profesionistëve të diasporës që përfunduan këtë studim raportuan se flasin rrjedhshëm dhe shkruajnë në gjuhën shqipe (85%) ose kanë një nivel të mirë (10%). Një përqindje më e vogël e të anketuarve kishin një nivel mesatar të të folurit ose të shkruarit në gjuhën shqipe.


²⁴ Murati, Mimoza (2020), intervistë e realizuar nga L.Krasniqi, me 24 Shkurt, 2020, përmes E-mail.

Arsimi dhe sfondi profesional

Kur bëhet fjalë për arsimin, rreth 41 përqind e të anketuarve kanë pohuar se kanë një diplomë Master, ndërsa shtatë përqind kanë ose po mbarojnë studimet e Doktoratës. Rreth 29 përqind kanë një diplomë Bachelor në

një fushë specifike ndërsa një përqind kanë mbaruar vetëm disa vite në universitet. Rreth 10 përqind kanë mbaruar shkollën profesionale dhe 10 përqind të tjerë kanë mbaruar shkollën e mesme.


Figura 8. Cili është niveli juaj më i lartë i edukimit?



Shumica e të anketuarve që banojnë jashtë vendit të origjinës aktualisht punojnë (87%)


krahasuar me 13 përqind të cilët nuk kanë punë për momentin.

Figura 9. A jeni duke punuar aktualisht?



Rreth një e treta e atyre që punojnë aktualisht (32%) janë të angazhuar si staf i lartë, ndërsa një e katërta janë duke punuar punë të nivelit të menaxhmentit / mbikëqyrjes (25%). Rreth 14 përqind e të anketuarve raportuan se janë në nivelin e kryeshefi ekzekutiv ose pronarë tkompanish, ndërsa rreth 24 përqind janë ose staf i ri ose menaxherë të ri.

Figura 10. Pozita aktuale e punës




"Është interesante të theksohet se shumica e të anketuarve janë në pozita të larta. Kjo do të thotë që këta njerëz kanë qasje në tregje dhe rrjete të rëndësishme, të cilat nuk janë vlerësuar në mënyrë adekuate nga vendet e origjinës. Kujtim Dobruna, një ekonomist dhe sipërmarrës në Vjenë, deklaron se ekziston një potencial i jashtëzakonshëm në mesin e diasporës që mbetet i pashfrytëzuar - më tepër në aspektin e burimeve njerëzore se atyre financiare.²⁵

Punët dhe profesionet parësore ndryshojnë për profesionistët e diasporës që marrin pjesë në këtë studim. Rreth 14 përqind janë inxhinierë, nëntë përqind janë duke punuar punë administrative, tetë përqind janë ekonomistë,

gjashtë përqind janë avokatë dhe gjashtë përqind janë mësues. Profesione të tjera përfshijnë studiues, analist financiar, shkencëtar politik, profesor, doktor, arkitekt, infermier dhe profesione të tjera.

Figure 11. Sfondi profesional




²⁵Dobruna, Kujtim (2020), intervistë e realizuar nga L.Krasniqi, me 24 Shkurt, 2020, përmes Skype.

Shumica e të anketuarve janë në punë me kohë të plotë (40 orë në javë) (76%), ndërsa 10 përqind janë duke punuar si të pavarur dhe 5 përqind janë të angazhuar për punë të bazuar në konsulencë (5%) e cila u lejon atyre të kenë

një orar e pune më fleksibil. Për më tepër, rreth nëntë përqind e të anketuarve janë në punë me gjysmë orari, duke kryer maksimum 20 orë në javë.


Figura 12. Përshkruani orarin tuaj të punës?



Kur u pyetën nëse puna e tyre aktuale përputhet me kualifikimin dhe aftësitë e tyre, shumica thanë "po" (85%) në krahasim me 15 përqind të tjerë të të anketuarve që nuk besojnë se puna e tyre përputhet mirë me kualifikimet e tyre aktuale. Grupi i cili beson se punët e tyre nuk përputhen me kualifikimet

dhe aftësitë e tyre, përmendin arsye të ndryshme, përfshirë gjuhën e huaj si pengesë për integrimin e tyre në vendin rezident (22%), mungesën e statusit ligjor për të punuar në fushën e tyre (19%), mungesën e lidhjeve dhe rrjeteve sociale (15%) dhe arsye të tjera.

Figura 13. A përputhen kualifikimet tuaja me punën tuaj të tanishme?




Për 22 përqind prej tyre, gjuha e huaj është një pengesë drejt gjetjes së një pune që përputhet me kualifikimet e tyre, ndërsa 19 përqind nuk e kanë statusin ligjor që do t'i lejonte ata të punojnë në fushën e tyre.

Ermal Vejsa, sociolog që jeton në Vjenë, Austri, beson se duke marrë parasysh qëllimet fillestare për zhvillimin profesional,

ai mund të bënte më shumë. Por, si një person që emigroi jashtë vendit për të studiuar me vetë-financim dhe filloi një jetë me shumë të panjohura në një vend të huaj, ai qëndron shumë i kënaqur me arritjet e tij. Ai shton se kjo është kryesisht për shkak të dëshirës dhe vullnetit të palëkundur, por edhe falë mundësive që ofron një vend siç është Austria.²⁶

Figura 13. 1. Nëse jo, pse?




²⁶Vejsa, Ermal (2020), intervistë e realizuar nga S.Bejtullahu me 26 Shkurt, 2020, përmes Skype.

Përceptimet mbi Angazhimin Profesional në Vendet e Origjinës

Kjo pjesë e raportit përqendrohet në vlerësimin e ekspertizës profesionale të ofruar nga profesionistë të Diasporës në të kaluarën dhe tendencën e tyre për angazhim në të ardhmen. Pyetësi fillon duke vlerësuar besimin individual të pjesëmarrësve për suksesin nëse nuk do të kishin emigruar nga vendet e tyre të

lindjes. Gjysma e të anketuarve besojnë se do të ishin shumë / deri diku të suksesshëm nëse nuk do të kishin emigruar jashtë vendit. Ekzistojnë pikëpamje të ekuilibruara midis atyre që janë neutralë dhe të tjerëve që besojnë se do të ishin jo aq të suksesshëm ose aspak nëse nuk do të largoheshin nga vendlindja.


Figura 14. Sa të suksesshëm mendoni që të ishit nëse nuk do të kishit emigruar nga vendi juaj?



Shumica e atyre që besuan se do të kishin një normë të mirë suksesi nëse nuk do të kishin emigruar, gjithashtu ndajnë të njëjtat besime, se do të ishin shumë / deri diku të suksesshëm nëse do të ktheheshin (65%), ndërsa më shumë se një e katërta e të anketuarve besojnë se nuk do të ishin aq të suksesshëm (27%). Rreth 20 përqind e të anketuarve që kishin pikëpamje neutrale

për suksesin e tyre nëse nuk do të kishin migruar, besojnë se do të ishin shumë / deri diku të suksesshëm nëse do të ktheheshin, dhe i njëjti numër beson të kundërtën. Nga ana tjetër, më shumë se gjysma e atyre që besojnë se do të kishin qenë deri diku / jo të suksesshëm nëse nuk do të migronin, besojnë të njëjtën normë suksesi nëse do të ktheheshin (53%).

Figura 15. Sa të suksesshëm mendoni se do të ishit nëse do të ktheheshit në vendin tuaj të origjinës (duke marrë parasysh përgjigjet e tyre në pyetjen e mëparshme "Sa të suksesshëm mendoni që të ishit nëse nuk do të kishit emigruar nga vendi juaj?")



Ndërkohë, të intervistuarit tanë japin mendime të ndryshme në lidhje me suksesin nëse nuk do të kishin emigruar, ose nëse do të ishin kthyer në vendin e origjinës. Lirjetë Avdiu, që aktualisht jeton në Vjenë, Austri, thotë se

“Do të kisha provuar, por nuk e di nëse do të kisha qenë e suksesshme nëse do të qëndroja në vendin tim. Nuk do t'i kisha mundësitë që Austria më ka ofruar për t'u zhvilluar në drejtimin e duhur profesional ose mundësinë për t'u bashkuar me rrjete profesionistësh me të cilët mund të komunikoj, krijoj dhe ndërtoj diçka.”²⁷

Kujtim Dobruna beson se “me edukimin e kryer jashtë vendit ai do të kishte qenë i suksesshëm nëse do të kthehej.”²⁸ Sidoqoftë, ai shton se përveç aspekteve edukative, ekzistojnë edhe disa elementë të tjerë, siç janë aftësitë ndërpersonale, dhe aftësitë profesionale dhe rrjetëzimi, përvoja, etj., të cilat do të ndikojnë në karrierën profesionale si brenda dhe jashtë vendit. Jetmira Kaziu, një tjetër

profesioniste shqiptare që jeton në Boston, SH.B.A., argumenton se nëse ajo do të kishte lidhjet e duhura në politikë, ajo ndoshta do të ishte financiarisht më mirë në Shqipëri sesa tani që është në SH.B.A., por jo më e suksesshme. Në këtë drejtim, ajo shton

“Unë punoj me një kompani në Shqipëri të cilët aktualisht janë klientët e mi. Por, po të jetoja në Shqipëri, unë do të kisha qenë një nga punonjësit e tyre.”²⁹

Një temë tjetër që prekim me këtë studim është shkalla në të cilën profesionistët e diasporës janë angazhuar me vendet e origjinës / vendet e lindjes përmes ndonjë aktiviteti ose projekti në vitet e fundit. Shumica e të anketuarve nuk kanë kontribuar apo punuar në

vendin e tyre si ekspert të jashtëm, në krahasim me 24 përqind të tjerëve që kanë vepruar. Nga ata që kanë kontribuar në vendlindje si ekspert të jashtëm në një moment (n=159), 56 përqind ishin nga Kosova, dhe 35 përqind ishin nga Shqipëria.

Figura 16. A keni qenë të angazhuar në vendet e origjinës si profesionist i diasporës?



²⁷ Avdiu, Lirjetë (2020), intervistë e realizuar nga L.Krasniqi, me 2 Mars, 2020, përmes Skype.


²⁸ Dobruna, Kujtim (2020), intervistë e realizuar nga L.Krasniqi, me 24 Shkurt, 2020, përmes Skype.

²⁹ Kaziu, Jetmira (2020), intervistë e realizuar nga L.Krasniqi, me 24 Shkurt, 2020, përmes E-mail.

Gjysma e atyre që nuk u angazhuan raportuan se kurrë nuk i'u ishin ofruar role ose mundësi të tilla (50%) dhe rreth 17 përqind deklaruan se nuk kishte iniciativa të përshtatshme që përputhen me ekspertizën e tyre. Për të

tjerët, puna e tyre e tanishme në vendin rezident i pengoi ata të angazhohen si ekspertë të jashtëm në vendin e origjinës (13%) ndërsa të tjerët nuk ishin të interesuar për ndonjë nga nismat e deritanishme (12%).


Figura 16.1 Nëse jo, pse?



Shumica e të anketuarve pohuan se nuk kanë marrë asnjë ftesë për të kontribuar në vendin

origjinës, në krahasim me 12 përqind të atyre që kanë marrë ftesa.

Figura 17. A keni marrë ndonjëherë ndonjë ftesë për t'u angazhuar profesionalisht në vendet e origjinës?



Eleonit Ismajli, një profesionist i ri që jeton në Cyrih të Zvicrës, argumenton se


*"Përtej mungesës së mundësive dhe iniciativave të duhura, një nga arsyt e mungesës së angazhimit të profesionistëve të diasporës në vendet e origjinës është se disa platforma / iniciativa të mëparshme nuk kanë qenë mjaft serioze ose kanë pasur pengesa / agjendë politike."*³⁰

³⁰Ismajli, Eleonit (2020), intervistë e realizuar nga L.Krasniqi, me 20 Shkurt, 2020, përmes Skype.

Sipas tij, kjo ka krijuar skepticizëm midis profesionistëve kur bëhet fjalë për angazhimin profesional me vendin amë. Sidoqoftë, ai shton se ekziston një vullnet i jashtëzakonisht i madh në diasporën shqiptare, veçanërisht në³¹ Në këtë temë, studimi u kërkoi të anketuarve të identifikojnë se çfarë do t'i stimulonte ata të angazhohen si ekspert në vendin e tyre të origjinës. Opsionet më të zgjedhura që do të shërbenin si stimuj për angazhimin e diasporës ishin serioziteti i iniciativave /

organizatorëve (62%), puna në projekte që lidhen me fushën e tyre të ekspertizës (56%), shpërblime financiare (27%), mundësia e dhënë për t'u angazhuar në vendlindjen e tyre (26%), fleksibiliteti i orarit të punës dhe angazhimit të tyre (22%), një lloj mirënjohjeje për kontributin e tyre (17%) dhe punën në projekte për një ndikim pozitiv në vendin e origjinës.

Figura 18. Çfarë do t'ju nxiste që të angazhoheni si ekspert në vendin e origjinës?



Lidhur me këtë temë, njëri prej të intervistuarve mendon se përveç stimujve drejt profesionistëve të diasporës, duhet të ketë marrëveshje të ndërsjella midis vendeve të origjinës dhe vendeve ku jeton diaspora, për aftësi të përkohshme, dhe / ose afatgjata dhe për transferimin e njohurive.³²

Lirjetë Avdiu sugjeron që është shumë e rëndësishme të ketë koordinim ose organizim të politikave kur bëhet fjalë për angazhimin profesional të diasporës. Ajo më tej argumenton se duhet të ketë një vlerësim të nevojave

dhe kërkesave të vendeve të origjinës për sa i përket fushave që kanë një deficit të ekspertizës së përparuar, e cila më pas do të harmonizohej me "furnizimin" nga diaspora.³³ Një tjetër e intervistuar shprehet se

"Kosova duhet t'u ofrojë më shumë arsye të rinjëve (veçanërisht) në diasporë për të vizituar Kosovën, përveç pushimeve dhe aktiviteteve rekreative. Të jesh në Kosovë më shpesh, dhe për më shumë arsye, do të kishte më shumë gjasa për t'u angazhuar profesionalisht."³⁴

³¹Po aty.

³²Vejsa, Ermal (2020), intervistë e realizuar nga S. Bejtullahu, me 26 Shkurt, 2020, përmes Skype.

³³Avdiu, Lirjetë (2020), intervistë e realizuar nga L.Krasniqi, me 2 Mars 2020, përmes Skype.


³⁴Avdiu, Lirjetë (2020), intervistë e realizuar nga L.Krasniqi, me 2 Mars 2020, përmes Skype.

Angazhimi i Ardhshëm i Mundshëm në Vendet e Origjinës

Pothuajse të gjithë pjesëmarrësit e anketës besojnë se aftësitë e tyre mund të jenë shumë / deri diku të dobishme për zhvillimin e vendit të origjinës (90%). Rreth nëntë përqind e të anketuarve kishin pikëpamje

neutrale për këtë çështje, ndërsa vetëm dy përqind e të anketuarve besojnë se aftësitë e tyre nuk do të mund të kishin ndonjë kontribut të madh.

Figura 19. A besoni se aftësitë tuaja do të ishin të dobishme për zhvillimin e vendit të origjinës?




Eleonit Ismajli thekson se një nga arsyet që e kishte në mendje kur vendosi për pjesën kryesore të studimeve të tij, ishte ndërlidhja e programit me angazhimin e tij të mundshëm në Kosovë.³⁵

Pavarësisht nëse është ftuar apo jo për të punuar si ekspert i jashtëm në vendin e origjinës, studimi synon të vlerësojë interesin e profesionistëve të diasporës për të kontribuar në të ardhmen si ekspertë në fusha të

ndryshme. Kur u pyetën se si do të ishin në gjendje që të japin një kontribut të tillë nëse u ofrohet mundësia, shumica do të ishte në gjendje të angazhohen fizikisht duke vizituar vendin amë ose virtualisht përmes platformave në internet. Ky konstatim i studimit është domethënës pasi tregon një interes të menjëhershëm për angazhim në çfarëdo forme për kontribut dhe ndikim pozitiv në vendin e origjinës.

³⁵Ismajli, Eleonit (2020), intervistë e realizuar nga L.Krasniqi, me 24 Shkurt, 2020, përmes Skype.


Figura 20. Si do të ishit në gjendje të kontribuonit nëse u jepet shansi dhe mundësia?



Për shumë të anketuar, si opsioni më i preferuar për angazhim do të ishin periudha të caktuara brenda vitit, si 4 deri në 6 javë në periudha të ndryshme kohore (44%). Rreth 21 përqind raportuan se ata do të ishin në gjendje të angazhohen nga 3 deri në 6 javë brenda vitit në vendin e origjinës. Sidoqoftë, rreth 14 përqind e të anketuarve raportuan nëse do kishin mundësi, ata do të angazhoheshin për më shumë se 6 muaj dhe potencialisht do të banonin në vendlindje përgjithmonë.

Koha e angazhimit të ekspertëve të diasporës është një nga elementet kryesore të përmendura nga të gjithë të intervistuarit, duke nënkuptuar se përkundër vullnetit të madh, për profesionistët e diasporës është e rëndësishme që të balancojnë kohën e tyre të punës në vendet rezidente dhe kohën e angazhimit ose kontributit në vendet e origjinës. Prandaj, është shumë e rëndësishme të gjejsh modalitetet optimale në lidhje me kohën e angazhimit profesional në vendet e origjinës.


Figura 21. Për cilën periudhë kohore do të ishit në gjendje të kontribuonit në vendin tuaj?



Kohët më të preferuara të vitit për t'u angazhuar u renditën në vijim në bazë frekuencës së opsioneve të zgjedhura: tremujori i tretë (korrik-shtator) (58%), tremujori i dytë (prill-qershor) (30%), tremujori i parë

(Janar-Mars) (26%) dhe Tremujori i fundit (Tetor-Dhjetor) (24%). Kjo do të thotë që muajt e verës mbeten si periudhat më të preferuara për profesionistët e diasporës, ku ata mund të angazhohen dhe të ofrojnë kontributin e tyre.


Figura 22. Cila periudhë gjatë vitit ju përshtatet më së miri për të kontribuar në vendin tuaj të origjinës?



Për më tepër, më shumë se gjysma e të anketuarve preferojnë të angazhohen në transferimin e njohurive dhe aftësive të tyre në Kosovë (56%), 30 përqind preferojnë të angazhohen në Shqipëri ndërsa katër përqind e të anketuarve do të jenë të gatshëm të angazhohen

me ekspertizën e tyre profesionale në të dy vendet. Një pjesë më e vogël e të anketuarve do të ishin të gatshëm të kontribuojnë në Maqedoninë Veriore dhe një përqind në Preshevë dhe një përqind në Mal të Zi.


Figura 23. Në cilin vend do të preferonit të transferonit njohuritë dhe aftësitë (kontributin) tuaja?



Kur bëhet fjalë për fusha profesionale për të kontribuar, rezultatet tregojnë se 19 përqind e profesionistëve të diasporës mund të kontribuojnë në fushën e Menaxhimit, Biznesit dhe Sipërmarrjes ndërsa 13 përqind do të angazhoheshin në Akademi dhe Kërkim shkencor. Rreth 11 përqind do të

angazhoheshin në fushën e Arsimit ndërsa 10 përqind mund të kontribuojnë në fushën e Drejtësisë, Ligjit dhe Sigurisë. Vendet e origjinës mund të përfitojnë nga angazhimi i diasporës në fusha të tjera gjithashtu, duke përfshirë Teknologjinë, Inxhinierinë, Arkitekturën dhe Planifikimin Urban.


Figura 24. Në cilën fushë profesionale mund të kontribuoni në zhvillimin e vendit tuaj?



Kur u pyetën rreth institucionit ose organizatës që profesionistët e Diasporës do të preferonin të angazhoheshin në vendin e origjinës, rreth 29 përqind pretenduan për Qeverinë apo Agjensitë Qeveritare, pasuar me 17 përqind që do të donin të përfshiheshin në organizata joqeveritare. Rreth 16 përqind e të

anketuarve do të ishin të gatshëm të kontribuojnë në institucionet e pavarura të shtetit ndërsa 15 përqind janë më të interesuar të punojnë për një Ndërmarrje / Kompani Publike. Pak më pak të anketuar zgjodhën Komunën / Kuvendin, Parlamentin dhe Universitetet Publike si institucione në të cilat ata ishin të gatshëm të angazhohen.


Figura 25. Në cilin institucion / organizatë do të preferonit të angazhoheni?



Rreth 32 përqind e të anketuarve do të ishin të gatshëm të angazhohen si profesionistë në vendin e tyre, me kusht që angazhimi të ofrojë shpërblime financiare sipas standardeve ekonomike të shtetit rezident dhe t'i përshtatet ekspertizës së tyre profesionale. Pak më pak të anketuar raportuan se do të angazhoheshin nëse angazhimet do të ofronin shpërblime financiare bazuar në standardin

ekonomik të vendit të origjinës dhe ekspertizën e tyre profesionale. Rreth 21 përqind pretenduan se për sa kohë që shpenzimet e tyre themelore ishin të mbuluara gjatë angazhimit të tyre, ata do të bashkoheshin me iniciativën. Dhe së fundi, 15 përqind e të anketuarve janë të gatshëm të kontribuojnë si profesionistë të diasporës në formën e një angazhimi vullnetar.

Figura 26. Në çfarë forme mendoni se do të ishte kontributi juaj në vendlindje?




Projekti për Angazhimin e Profesionistëve të Diasporës dhe Angazhimi në të Ardhmen

Të anketuarit u pyetën të japin mendimin e tyre në lidhje me iniciativën "Angazhimi i Profesionistëve të Diasporës" siç tregohet në grafikun më poshtë. Shumica besojnë se kjo është një iniciativë shumë e dobishme në kohën e duhur duke marrë parasysh që diaspora ka shumë potencial për të ndikuar pozitivisht në vendet e origjinës. Pak më pak të anketuar besojnë se iniciativa është shumë e dobishme por deri diku e vonuar sepse diaspora është

disi e dekurajuar dhe i mungon interesi për të kontribuar. Gjashtë përqind e tjerë besojnë se iniciativa është deri diku e dobishme, por ka mënyra më të mira për të filluar angazhimin e Diasporës në vendet e lindjes. Vetëm një përqind e të anketuarve mendojnë se iniciativa nuk është e dobishme, ndërsa dy përqind janë skeptikë dhe do t'u duheshin më shumë informacione për të qenë në gjendje të bëjnë një vlerësim më të mirë.


Figura 27. Si do ta përshkruanit nismën "Angazhimi i Profesionistëve të Diasporës"?



Rreth 76 përqind e pjesëmarrësve në këtë studim pretenduan se ishin të gatshëm dhe deri diku të gatshëm për të ofruar kontributin e tyre në vendin e origjinës në krahasim me

pesë përqind që nuk janë. Për më tepër, 19 përqind e të anketuarve kanë pikëpamje neutrale në lidhje me këtë nismë.


Figura 28. Sa jeni gatshëm që të ofroni kontributin tuaj në vendin e origjinës përmes programit "Angazhimi i Profesionistëve të Diasporës"?



Shumica e të anketuarve do të kishin nevojë për një lehtësim për t'u përfshirë përmes këtij programi në formën e ftesës zyrtare nga organizatorët me fushën e punës (53%) dhe marrjen e një oferte serioze me objektiva të qarta për kontribut përmes punës së tyre (15%). Përveç këtyre stimulujve, rreth katër përqind e të anketuarve do të kishin nevojë për një ofertë dhe kushte të qarta të punës para angazhimit, dhe katër përqind e tjerë kanë

përmendur që të kenë fleksibilitet për sa i përket angazhimit të tyre gjatë gjithë vitit si dhe njoftim paraprak për të bërë marrëveshje me punëdhënësin e tyre në shtetin rezident. Stimuj tjerë që do të ofrohen janë projektet në fushën e tyre të ekspertizës, një mjedis i qëndrueshëm politik dhe ekonomik, dhe mbështetje e bashkëpunim i vazhdueshëm me anëtarët e diasporës

Figura 29. Çfarë do ju nevojtej për ta lehtësuar angazhimin tuaj përmes këtij programi?



Konkluzione

Kosova dhe Shqipëria kanë diasporë të mëdhe dhe me potencial të madh; megjithatë, ky potencial ka mbetur kryesisht i pakesploruar përtej remitencave dhe mbështetjes financiare për vendet amë. Për të përshtatur sa më mirë objektivat e projektit për bashkëpunim të suksesshëm, Germin kreu një studim online me 921 profesionistë të diasporës, të cilëve u referohen 'si njerëz të kualifikuar dhe të aftë me prejardhje migracioni, të cilët dëshirojnë të mbështesin vendin e tyre të origjinës duke e vënë në përdorim ekspertizën e tyre', siç përcaktohet nga Qendra për Migrim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (CIM).

Kur bëhet fjalë për gatishmërinë e profesionistëve që marrin pjesë në këtë studim për t'u përfshirë në këtë nismë, rezultatet tregojnë se shumica janë të gatshëm (76%) për të ofruar kontributin e tyre në vendin e origjinës. Shumica e të anketuarve pohuan se ata do të ishin në gjendje të angazhoheshin fizikisht duke vizituar vendin amë ose virtualisht përmes platformave në internet. Ky konstatim i studimit është domethënës pasi tregon një interes të menjëhershëm për angazhim në çfarëdo forme për kontribut dhe ndikim pozitiv në vendin amë/e origjinës.

Më shumë se gjysma e të anketuarve kanë nevojë për një lehtësim për t'u angazhuar përmes këtij programi në formën e ftesës zyrtare nga organizatorët në fushën e punës (53%) dhe marrjen e një oferte serioze me objektiva të qarta për kontribut përmes punës së tyre (15%). Përveç këtyre stimuljeve, rreth katër përqind e të anketuarve do të kishin nevojë për një ofertë dhe kushte të qarta të

punës para angazhimit, dhe katër përqind e tjerë kanë përmendur që të kenë fleksibilitet përse i përket angazhimit të tyre gjatë gjithë vitit si dhe njoftim paraprak për të bërë marrëveshje me punën e tyre në shtetin rezident.

Rreth një e treta e të anketuarve do të ishin të gatshëm të angazhohen si profesionistë në vendin e tyre, me kusht që angazhimi të ofrojë shpërblime financiare sipas standardeve ekonomike të shtetit rezident dhe të përshtatet me ekspertizën e tyre profesionale.

Për shumë të anketuar, opsioni më i preferuar për angazhim do të ishin periudha të caktuara brenda vitit, si 4 deri në 6 javë në periudha të ndryshme kohore (44%). Rreth 21 përqind raportuan se ata do të ishin në gjendje të kryenin nga 3 deri në 6 javë brenda vitit në vendin e tyre. Ndërsa, rreth 14 përqind e të anketuarve raportuan se nëse do kishin mundësi, ata do të angazhoheshin për më shumë se 6 muaj dhe potencialisht do të banonin në vendlindje përgjithmonë.

Shumë prej pjesëmarrësve në këtë studim pohuan se besojnë se aftësitë e tyre mund të jenë shumë të dobishme për zhvillimin e vendit të origjinës (63%) ndërsa 27 përqind besojnë se aftësitë e tyre mund të jenë deri diku të dobishme. Ndërsa 54 përqind besojnë se do të ishin shumë dhe deri diku të suksesshëm nëse do të ktheheshin, 25 përqind mbajnë pikëpamje neutrale për këtë çështje dhe 21 përqind besojnë se ata do të ishin jo aq të suksesshëm ose aspak të suksesshëm.

Për më tepër, më shumë se gjysma e të anketuarve preferojnë të angazhohen në transferimin e njohurive dhe aftësive të tyre në Kosovë

(56%), 30 përqind preferojnë të përfshihen në Shqipëri ndërsa katër përqind e të anketuarve do të jenë të gatshëm të angazhohen me ekspertizën e tyre profesionale në të dy vendet. Fushat kryesore të kontributit profesional nga diaspora janë Menaxhimi, Biznesi dhe Sipërmarrja, si dhe Akademia dhe Kërkimi. Rreth 11 përqind do të angazhohen në fushën e Arsimit, ndërsa 10 përqind mund të kontribuojnë në fushën e Drejtësisë, Ligjit dhe Sigurisë.

Përveç faktit se shumë nga profesionistët e diasporës të përfshirë në studim raportuan se ishin vendosur tashmë në vendet jashtë, ky studim tregon se ekziston një gatishmëri e profesionistëve të diasporës për t'u angazhuar dhe kontribuar, duke pasur parasysh stimujt e duhur dhe organizimin serioz të projektit.

Recommendations

1. NJOHJA ME PROFESIONISTËT SHQIPTARË TË DIASPORËS; NJIHUNI ME SHPËRNDARJEN E TYRE DËGJOJINI DHE KUPTOJINI

Institucionet shtetërore duhet të përdorin mekanizma të shumtë për mbledhjen e informacionit dhe të dhënave për të krijuar një profil të diasporës, i cili shpjegon karakteristikat kryesore të diasporës, ekspertizën e tyre, si dhe nevojat e anëtarëve dhe organizatave të diasporës. Ambasadat dhe Konsullatat e Kosovës dhe të Shqipërisë duhet të jenë më aktive në marrjen e informacionit të azhurnuar në lidhje me qytetarët që jetojnë jashtë. Ky studim riafirmon që diaspora shqiptare është shumë e larmishme për sa i përket sfondit profesional, por gjithashtu rikonfirmon lidhjen e fortë dhe gatishmërinë e saj për të kontribuar në vendet e origjinës - vendet amë. Sidoqoftë, treguesit e këtij studimi rrjedhin nga një mostër e vogël, dhe është shumë e nevojshme që diaspora profesionale të njihet më shumë dhe në më shumë nuanca. Pa pasur njohuri të duhur për profilet e diasporës, është shumë e vështirë për vendet e origjinës të hartojnë politika adekuate për angazhimin e saj dhe ndikimin pozitiv në proporcion me potencialin që ata kanë.

2. TË FUQIZOHEN GRUPET DHE ORGANIZATAT E DIASPORËS

Fuqizimi i grupeve dhe organizatave të diasporës është një faktor shumë i rëndësishëm që ndikon në përkushtimin e diasporës për një angazhim më intenziv dhe të strukturuar në vendet e origjinës. Organizatat me bazë dhe/ose të orientuara në diasporë lehtësojnë integrimin dhe ofrojnë mbështetje për migrantët në vendet rezidente por edhe ato të origjinës. Kjo i bën ata aktorë të rëndësishëm, gjë që duhet të njihet dhe vlerësohet. Prandaj, ne e konsiderojmë fuqizimin e

grupeve dhe organizatave të diasporës si një proces të domosdoshëm për përfshirjen e tyre në zhvillimin e vendeve të origjinës. Fuqizimi nënkupton forma të ndryshme të mbështetjes, duke filluar nga mbështetja institucionale e deri tek mbështetja financiare që u ofrohet organizatave të diasporës për të rritur kapacitetet e tyre. Kjo e fundit, për shembull, mund të sigurohet përmes një skeme të financimit institucional, e siguruar nga vetë qeveria ose aktorë të tjerë, të tillë si organizata ndërkombëtare ose agjensi zhvillimi.

3. ZHVILLIMI I NJË PLATFORME SHUMË-FUNKSIONALE QË LIDHË PROFILET E PROFESIONISTËVE TË DIASPORËS ME SEKTORIN PUBLIK DHE PRIVAT NË VENDET E ORIGJINËS

Ekziston një nevojë urgjente që qeveria të bashkëpunojë me sektorë të ndryshëm (publik dhe privat) në mënyrë që të hartojë një platformë shumë-funksionale që synon të rimendojë angazhimin e komuniteteve tona jashtë vendit dhe të ndryshojë mënyrën tradicionale se si ne e kemi parë diasporën tonë. Kjo është veçanërisht e rëndësishme sepse nëse analizojmë vendet që kanë përvojë dhe strategji të suksesshme në angazhimin e diasporës (Irlanda, Izraeli, India), shohim se rezultati vjen nga njohja, krijimi i rrjeteve, partneriteti dhe qasja e koordinuar e shumë palëve të përfshira në këtë proces. Për më tepër, duke kuptuar potencialin e këtij burimi njerëzor të pashfrytëzuar, ne duhet ta shohim diasporën si një pikë hyrëse, lehtësuese dhe aset diplomatik, e cila duke u takuar në një platformë të shumë-funksionale do të hapte mundësi të reja.

4. TË KRIJOHET HAPËSIRË PËR ANGAZHIMIN E PROFESIONISTËVE TË DIASPORËS NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË KOSOVËS DHE SHQIPËRISË, TË CILAT KANË MUNGESË TË NJOHURIVE DHE AFTËSIVE TË AVANCUARA NË SEKTORET KYÇE

Për shkak të mungesës së njohurive në sektorët kryesorë, institucionet e Kosovës dhe Shqipërisë kanë nevojë të madhe për ekspertizë dhe mentorim. Të dyja lehtë mund të fitohen nga profesionistë të diasporës nëse krijohet hapësira e nevojshme. Shumica e të anketuarve dhe të intervistuarve të këtij studimi besojnë se aftësitë dhe njohuritë e tyre të fituara jashtë vendit do të ishin shumë të dobishme për zhvillimin e vendeve të origjinës, dhe ata janë të gatshëm të kontribuojnë në transferimin e njohurive të tyre. Më pak se një e katërta e tyre kanë pasur mundësinë të jenë të angazhuar profesionalisht në këto vende, ndërsa gjysma e çerekut janë ftuar. Mungesa e programeve të shkëmbimit, si dhe një kulturë e mbyllur dhe nepotiste e administratës publike të shteteve përkatëse janë ndër arsytet që nuk kanë lejuar hapësirë për ekspertizën e diasporës. Kjo është arsyeja pse një shumicë e lartë (74%) e të anketuarve nga kjo anketë mendojnë se nisma e Germinit (e mbështetur nga GIZ), vjen në kohën e duhur duke marrë parasysh që diaspora ka shumë potencial për të ndikuar pozitivisht në vendet e origjinës. Vetëm disa besojnë se iniciativa është shumë e dobishme, por deri diku e vonuar sepse diaspora është deri diku e dekurajuar dhe i mungon interesi për të kontribuar. Për të shmangur këto të fundit, institucionet shtetërore në Kosovë dhe Shqipëri duhet të ofrojnë më shumë hapësirë për angazhimin e profesionistëve të diasporës, veçanërisht në

5. TË PËRMIRËSOHET KOORDINIMI MIDIS NIVELEVE TË NDRYSHME TË QEVERISJES DHE INSTITUCIONEVE NDËR-SHTETËRORE DHE TË RRYTET GJITHËPËRFSHIRJA NË PROCESIN E ANGAZHIMIT TË DIASPORËS

Angazhimi i diasporës është një proces i ndërlikuar që përfshin shumë tema dhe sektorë (ekonomikë, politikë, kulturorë dhe social). Ky proces përfshin një varg organesh dhe nivelesh institucionale kombëtare dhe lokale. Në këtë drejtim, identifikimi i palëve të interesuara të duhura dhe koordinimi midis niveleve të ndryshme të qeverisjes dhe institucioneve është thelbësor. Për më tepër, duke pasur parasysh që orientimi i diasporës shqiptare drejt atdheut është i drejtuar në më shumë sesa një vend/shtet, angazhimi i saj është çështje e të paktën dy shteteve, prandaj koordinimi edhe i institucioneve ndër-shtetërore është shumë i nevojshëm, siç është bashkëpunimi përmes një qasje gjithëpërfshirëse në zhvillimin e politikave, të qëndrueshme dhe të orientuar nga e ardhmja.

Referencat:

1. "Diaspora e Shqipërisë në Shifra". Instat.Gov.AL, 2019. <http://www.instat.gov.al/media/6547/diaspora-2019.pdf>.
2. "Diaspora Experts". Cimonline.De, 2020. <https://www.cimonline.de/en/html/diaspora-experts.html>.
3. "Kosovo Remittance Study". United Nations Development Programme, 2012. https://www.undp.org/content/dam/kosovo/docs/Remittances/KRS2012_English_858929.pdf.
4. "Remitancat: Një Mbështetje Për Zhvillim". Banka e Shqipërisë, 2018. https://www.bankofalbania.org/rc/doc/Remitancat_Revisa_11930.pdf.
5. Albanians in the World, Ministry for Europe and Foreign Affairs, qasur me 21 Maj 2020, <https://bit.ly/2ZOcDEG>
6. Arenliu et al (2014) Kosovo Human Development Report (2014) United Nations Development Programme, Swiss Cooperation Office Kosovo https://www.ecoi.net/en/file/local/1079594/1226_1418899302_undp-kosovo.pdf
7. Dahiden, Warner (2009) Diaspora as a Driving Tool for Development in Kosovo, Myth or Reality Swiss Agency for Development and Cooperation and Forum for Democratic Initiatives https://www.eda.admin.ch/dam/deza/en/documents/laender/resource-183043_EN.pdf
8. De Haas, Hein, (2010), "Migration and Development: A Theoretical Perspective." International Migration Review 44, no. 1: 227-64.
9. Debass, T., & Ardovino, M. (2009). Diaspora direct investment (DDI): The untapped resource for development. United States Agency for International Development. USAID publication, website: http://pdf.usaid.gov/pdf_docs/PNADO983.pdf.
10. "Kosovo | Remittances | Economic Indicators". Ceicdata.Com. Qasur me 21 Janar 2020. <https://www.ceicdata.com/en/kosovo/balance-of-payments-remittances-by-channel/remittances>.
11. Levitt, P. (1998). Social Remittances: Migration Driven Local-Level Forms of Cultural Diffusion. The International Migration Review, 32(4), 926-948.
12. Markova, Eugenia (2010), "Effects of Migration on Sending Countries: lessons from Bulgaria," GreeSE – Hellenic Observatory Papers on Greece and Southeast Europe 35, Hellenic Observatory, LSE. <http://eprints.lse.ac.uk/28438/>.
13. Nushi, A., & Alishani, A. (2012). Migration and development: the effects of remittances on education and health of family members left behind for the case of Kosovo. Analytical, 5(1), 42-57.
14. Rolandi F., Elia Ch, (2019) Escape from the Balkans, European Data Journalism, Osservatorio Balcani Caucaso Transeuropa <https://bit.ly/2OKp1PD>
15. Sax, L.J., Gilmartin, S.K. & Bryant, A.N (2003). Assessing Response Rates and Nonresponse Bias in Web and Paper Surveys. Research in Higher Education 44, 409-432. <https://doi.org/10.1023/A:1024232915870>

16. Sharma et al (2011), Realizing the development potential of diaspora, United Nations University Press ISBN 978-9280811957 <https://collections.unu.edu/eserv/UNU:2532/e-brary9789280811957.pdf>

17. Uraguchi et al, (2018), Diaspora Communities as a Driving force for Development: Is there a “Business case” HELVETAS. <https://bit.ly/2OIYPoo>

18. Walker Sh. (2019), Eastern Europe’s extraordinary revival, The Guardian <https://bit.ly/39faBQK>

19. Avdiu, Lirjetë (2020), intervistë e realizuar nga L.Krasniqi, me 2 Mars, 2020, përmes Skype.

20. Dobruna, Kujtim (2020), intervistë e realizuar nga L.Krasniqi, me 24 Shkurt, 2020, përmes E-mail.

21. Kaziu, Jetmira (2020), intervistë e realizuar nga L.Krasniqi, me 24 Shkurt, 2020, përmes E-mail.

22. Ismajli, Eleonit (2020), intervistë e realizuar nga L.Krasniqi, me 20 Shkurt, 2020, përmes Skype.

23. Murati, Mimoza (2020), intervistë e realizuar nga L.Krasniqi, me 24 Shkurt, 2020, përmes E-mail.

24. Vejsa, Ermal (2020), intervistë e realizuar nga S.Bejtullahu me 26 Shkurt, 2020, përmes Skype.



KORRIK 2020